



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:099606
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05741161

K.DH.Shk II.nr. 427/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Mitrovica” Sh.A, me seli në Mitrovicë, rr. “Liqenit”, kundër debitorit Trepça Sh.A - “Flotacioni – Tunel i Parë”, me nr. unik identifikues 811278747 dhe me seli në Mitrovicë, rr. “Bizsten”, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 70/23 të datës 20.12.2023, me datë 28.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Trepça Sh.A, me seli në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 70/23 të datës 20.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 70/23 të datës 20.12.2023, ne pikën I ka Refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit “Trepça” Sh.A., me seli në Mitrovicë ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 310/22, i lejuar me datë 30.12.2022,

nga Përmbauesi Privat Isa Shala, ndërsa ne piken II Urdhri Përmbauesi P.nr. 310/22, i lejuar me datë 30.12.2022, nga Përmbauesi Privat Isa Shala, mbetet ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 70/23 të datës 20.12.2023.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë,

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbauese si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Mitrovica" Sh.A, me dt. 30.12.2022, ka paraqitur propozim për përmbauesi mbi bazën e Kartelës Financiare te Konsumatorit me shifrën 1181 për periudhën kohore nga data 31.10.2020 e deri më datë 29.12.2022, ashtu që është detyruar debitori që në emër të borxhit të papaguar për shërbimet e furnizimit me ujë, t'ia paguaj kreditorit detyrimin në vlerë prej 115,621.36 EUR (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e një euro e tridhjetë e gjashtë euro cent) si dhe shpenzimet e procedurës përmbauese. Po ashtu Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësime duke kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbauesi faktin se kërkesa që rrjedh nga dokumenti i besueshëm është parashkruar, kjo në kuptim të nenit 360 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të pranohet ndërsa urdhri për lejimin e përmbauesi të anulohet. Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar tërësi pretendimet e ngritura nga debitori, duke sqaruar se nuk qëndron pretendimi se borxhi është përfshirë në parashkrim, kjo sepse në rastin konkret, kemi të bëjmë me dy persona juridik, andaj vie në shprehje aplikimi i nenit 355 të LMD-së i cili parasheh afatin tre (3) vjeçar të parashkrimit. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të refuzohet ndërsa urdhri për lejimin e përmbauesi të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim: Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të LPP-së, si dokumente të besueshme listohen “ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave” ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.

Gjykata e shkallës së parë gjeti urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – Kartelë financiare të konsumatorit me shifrën 1181 e cila i ka atributet e një ekstrakti nga librat afarist i cili parashihet si dokument i besueshëm në kuptim të nenit 29, par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, dhe përmban të gjitha elementet e kërkuara me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, meqenëse në këtë dokument janë treguar palët, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i ekstraktit, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Po ashtu kjo Gjykate ka gjetur se dokumenti mbi bazën e të cilës është lejuar urdhri përmbartimor i plotëson kushtet edhe në kuptim të nenit 37 të LPP-së, pasi që i njëjti i është bashkangjitur propozimit për përmbartim në origjinal, andaj edhe është i përshtatshëm për përmbartim dhe paraqet bazë për lejimin e përmbartimit.

Gjykata e shkallës së parë pati parasysh edhe pretendimet e debitorit se borxhi që buron nga ky ekstrakt është përfshirë në parashkrim, pasi që ka kaluar afati një (1) vjeçar i parashkrimit nga neni 360 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, por që në rastin konkret, meqenëse kemi të bëjmë me një raport afarist mes dy subjekteve juridike, atëherë vie në shprehje aplikimi i dispozitave nga neni 355 i LMD-së me të cilin parashihet se “Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer.”

Andaj meqenëse borxhi në ekstraktin nga librat afarist është grumbulluar për periudhën kohore nga data 31.10.2020 e deri më datë 29.12.2022, ndërsa propozimi për përmbaerim është paraqitur me datë 29.12.2022, rezulton se borxhi i kërkuar në propozimin për përmbaerim nuk ka kaluar afatin tre (3) vjeçar i parashkrimit nga neni 355 i LMD-së.

Andaj meqenëse borxhi në ekstraktin nga librat afarist është grumbulluar për periudhën kohore nga data 31.10.2020 e deri më datë 29.12.2022, ndërsa propozimi për përmbaerim është paraqitur me datë 29.12.2022, rezulton se borxhi i kërkuar në propozimin për përmbaerim nuk ka kaluar afatin tre (3) vjeçar i parashkrimit nga neni 355 i LMD-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe ankesës se parashtruar ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të përmbaerimit.

Andaj bazuar në të lartë cekurat, dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore të debitorit lidhur me pretendimin e tij se propozimi për përmbaerim në bazë të dokumentit të besueshëm – Kartelë financiare të konsumatorit me shifrën 1181 e cila i ka atributet e një ekstrakti nga librat afarist i cili parashihet si dokument i besueshëm në kuptim të nenit 29, par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, dhe përmban të gjitha elementet e kërkua me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, dhe në këtë dokument janë treguar palët, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i ekstraktit, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Tutje kjo gjykatë thekson se borxhi në ekstraktin nga librat afarist është grumbulluar për periudhën kohore nga data 31.10.2020 e deri më datë 29.12.2022, ndërsa propozimi për

përmbarrim është paraqitur me datë 29.12.2022, rezulton se borxhi i kërkuar në propozimin për përmbarrim nuk ka kaluar afatin tre (3) vjeçar i parashkrimit nga neni 355 i LMD-së.

Po ashtu borxhi në ekstraktin nga librat afarist është grumbulluar për periudhën kohore nga data 31.10.2020 e deri më datë 29.12.2022, ndërsa propozimi për përmbarrim është paraqitur me datë 29.12.2022, rezulton se borxhi i kërkuar në propozimin për përmbarrim nuk ka kaluar afatin tre (3) vjeçar i parashkrimit nga neni 355 i LMD-së.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar. Më te drejt gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se debitori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 73 par.3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K. DH.Shk II.nr. 427/24 me datë 28.05.2024

**Gjyqtarja,
Saranda Bogaj Sheremeti**